



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

AUTORITETI SHËNDETËSOR RAJONAL TIRANË

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Krijon”shpk

Adresa: Rruga “Todi Shkurti”, Pallati 5/1, Shk.1, Ap.2, Tiranë

Procedura e prokurimit: “Blerje kite reagentë”

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF- 09012-02-18-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje kite reagentë”

Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës: 13,107,984.82 (trembëdhjetë milion e njëqind e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër pikë tetëdhjetë e dy) lekë pa tvsh, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit referuar planit të buxhetit për Autoritetin Kontraktor: Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë, për vitin ushtrimor 2019 të miratuar me shkresë nr. 294 prot, datë 26.01.2019, nr. hyrës prot. 147, datë 21.02.2019, i ndryshuar.

Shumatorja e çmimeve për njësi të marrëveshjes kuadër: 1,083,929.73 (një milion e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e njëzetë e nëntë pikë shtatëdhjetë e tre) lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr: 8 dt. 25.02.2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme X çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Almedical” shpk

NIPT:K21511002I

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar: 0 (zero) leke.

Vlera e pritshme e kontrates: 0 (zero) leke.

2. Operatori ekonomik ”Euromed” shpk

NIPT: K71718012P

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar: 0 (zero) leke.

Vlera e pritshme e kontrates: 0 (zero) leke

3. Z. Fatos Lashi, person fizik

NIPT: K91315005H

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar: 765.182 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa tvsh

Vlera e pritshme e kontrates: 13.028.800 (trembëdhjetë milion e njëzetë e tetë mijë e tetëqind) lekë pa tvsh.

4. Operatori ekonomik "Genius" shpk

NIPT: K63121801C

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar: Nuk ka deklaruar

Vlera e pritshme e kontrates: 9.896.871 (nëntë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e një) lekë pa tvsh.

5. Operatori ekonomik "Krijon" shpk

NIPT: K12023001A

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar: 422.325 (katërqind e njëzetë e dy mijë e treqind e njëzetë e pesë) lekë pa tvsh

Vlera e pritshme e kontrates: 10.098.030 (dhjetë milion e nëntëdhjetë e tetë mijë e tridhjetë) lekë pa tvsh.

6. Operatori ekonomik "Medial" shpk

NIPT: L61306009P

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar: 777.000 (shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa tvsh

Vlera e pritshme e kontrates: 11.721.571 (njëmbëdhjetë milion e shtatëqind e njëzetë e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- **Operatori ekonomik "Almedical" shpk**
- **Operatori ekonomik "Euromed" shpk**
- **Z. Fatos Lashi, person fizik**
- **Operatori ekonomik "Genius" shpk**
- **Operatori ekonomik "Medial" shpk**

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- **Operatori ekonomik "Almedical" shpk**

Operatori ekonomik «Almedical» shpk nuk ka paraqitur ne SPE: «Formularin e ofertës ekonomike» duke mos plotësuar kështu pikën 2 (gërma ç) të kriterëve të vecanta të kualifikimit në Dokumentat Standarte të Tenderit.

Referuar Dokumentave Standarte të tenderit: 2; Kriteret e vecanta të kualifikimit, 2.3: Kapaciteti teknik, paragrafi 9, ndryshuar me anë të Shtojcës "A" publikuar në SPE në datë

Adresa: Rruga: "Qamil Guranjaku", Tirane, Shqiperi, Tel +3554347439, ash@shendetsia.gov.al

20.02.2019 në të cilën kërkohet: *Të paraqiten kampione / mostra për artikujt të shenjuar me yll (*)*. Diten e hapjes së garës duhet të paraqiten kampionet për pikat referuese: 1, 13, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 85, 86, 129,130, 131,133, 134, 137, 138, 161“.

Në dt. 08.04.2018 ora 10.00 që përkon me afatin e fundit të përcaktuar për hapjen e ofertave , Operatori ekonomik “Almedical” shpk nuk ka paraqitur mostrat e kërkuar në kriterin e sipërcituar duke mos e përmbushur atë.

Operatori ekonomik «Almedical» shpk nuk ka paraqitur ne SPElistë pagesat e punonjësve për tre muajt e fundit duke mos plotësuar kriterin e vendosur ne paragrafin 4, pika 2.2 kapaciteti ekonomik dhe financiar të Kritereve të vecanta për kualifikim. Ne përgjigje të kërkesave për kualifikim referuar kapacitetit teknik të ofertuesit të përcaktuara në pikën 2.3 të kritereve të vecanta të kualifikimit Operatori ekonomik „Almedical“ nuk ka dorëzuar elektronikisht ne SPE asnjë dokument në përmbushje të kritereve të vendosura në këtë rubrikë përvec dokumentit të kërkuar në paragrafin 7, “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, duke mos plotësuar asnjë nga kriteret e tjera të vendosura në këtë seksion.

- **Operatori ekonomik ”Euromed” shpk**

Operatori ekonomik «Euromed» shpk nuk ka paraqitur ne SPE: «Formularin e ofertës ekonomike» duke mos plotësuar kështu pikën 2 (gërma ç) të kritereve të vecanta të kualifikimit në Dokumentat Standarte të Tenderit. si dhe asnjë dokumentacion tjetër në përmbushje të kërkesave të kualifikimit, përvec Vertetimit të Debisë të lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, duke mos plotësuar kështu asnjë prej kërkesave për kualifikim të vendosura në Dokumentat Standarte të tenderit.

Gjithashtu referuar Dokumentave Standarte të tenderit: 2; Kriteret e vecanta të kualifikimit, 2.3: Kapaciteti teknik, paragrafi 9, ndryshuar me anë të Shtojcës “A” publikuar në SPE në datë 20.02.2019 në të cilën kërkohet: *Të paraqiten kampione / mostra për artikujt të shenjuar me yll (*)*. Diten e hapjes së garës duhet të paraqiten kampionet për pikat referuese: 1, 13, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 85, 86, 129,130, 131,133, 134, 137, 138, 161“. Në dt. 08.04.2018 ora 10.00 që përkon me afatin e fundit të përcaktuar për hapjen e ofertave, Operatori ekonomik “Euromed” shpk nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara në kriterin e sipërcituar duke mos e përmbushur atë.

- **Z. Fatos Lashi, person fizik**

Referuar Dokumentave Standarte të tenderit: 2; Kriteret e vecanta të kualifikimit, 2.3: Kapaciteti teknik, paragrafi 9, ndryshuar me anë të Shtojcës “A” publikuar në SPE në datë 20.02.2019 në të cilën kërkohet: *Të paraqiten kampione / mostra për artikujt të shenjuar me yll (*)*. Diten e hapjes së garës duhet të paraqiten kampionet për pikat referuese: 1, 13, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 85, 86, 129,130, 131,133, 134, 137, 138, 161“. Në dt. 08.04.2018 ora 10.00 që përkon me afatin e fundit të përcaktuar për hapjen e ofertave, Z. Fatos Lashi, person fizik, nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara në kriterin e sipërcituar duke mos e përmbushur atë.

Ofertuesi nuk ka paraqitur dokumentacion mbi furnizimet e mëparshme të ngjashme duke mos përmbushur kështu kriterin e vendosur në paragrafin e parë të pikës 2.3 (Kapaciteti teknik) të kritereve të vecanta për kualifikim në dokumentat Standarte të tenderit.

Nuk është paraqitur nga ofertuesi “Autorizimi për tregëtim të paisjeve mjekësore” duke mos plotësuar kështu kriterin e vendosur në paragrafin 7 të pikës 2.3 (Kapaciteti teknik) të kriterëve të vecanta për kualifikim në dokumentat Standarte të tenderit.

Ofertuesi nuk ka paraqitur katalogët teknik për artikujt e ofruar duke mos plotësuar kriterin e vendosur në paragrafin 7 të pikës 2.3 (Kapaciteti teknik) të kriterëve të vecanta për kualifikim në dokumentat Standarte të tenderit.

Ofertuesi nuk ka paraqitur në SPE vetëdeklaratën me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8 duke mos plotësuar kështu Kriteret e Përgjithshme për praninë të vendosura në Dokumentat Standarte të Tenderit.

- **Operatori ekonomik ”Genius” shpk**

Referuar Dokumentave Standarte të tenderit: 2; Kriteret e vecanta të kualifikimit, 2.3: Kapaciteti teknik, paragrafi 9, ndryshuar me anë të Shtojcës “A” publikuar në SPE në datë 20.02.2019 në të cilën kërkohet: Të paraqiten kampione / mostra për artikujt të shenjuar me yll (*). Ditën e hapjes së garës duhet të paraqiten kampionet për pikat referuese: 1, 13, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 85, 86, 129, 130, 131, 133, 134, 137, 138, 161. Në dt. 08.04.2018 ora 10.00 që përkon me afatin e fundit të përcaktuar për hapjen e ofertave, Operatori ekonomik “Genius” shpk, nuk ka paraqitur mostrat e kërkuar në kriterin e sipërcituar duke mos e përmbushur atë.

Operatori ekonomik «Genius» shpk në formularin e ofertës ekonomike ka deklaruar vetëm cmimin total të ofertës (vlerën e pritshme të kontratave) dhe nuk ka deklaruar shumatoren e cmimit për njësi duke rënë në kundërshti me pikën 1. Njoftimi i kontratës, Seksioni 2, Objekti i kontratës, pika 2.8 Pershkrimi i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuader, pika 2, e ndryshuar me anë të shtojcës ”D”, publikuar në SPE në datë 29.03.2019, në mbështetje të udhëzimit nr. 15, datë 26.11.2018 “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 6, datë 16.01.2018, për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”: ku parashikohet se: *“Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj Autoriteti Kontraktor përveç vlereës së pritshme të kontratave do të përlllogarisë edhe shumatoren e cmimeve për njësi e cila duhet të publikohet së bashku me vlerën e pritshme të kontratave (fondi limit) në njoftimin e kontratës.* si dhe në vijim duke mos plotësuar përcaktimin e bërë në Seksionin 4 “Procedura”, pika 4.2: Kriteret e përzgjedhjes së fituesit, gërma A plotësuar / ndryshuar me shtojcën “D”, të publikuar në SPE në datë 29.03.2019 në të cilën në mbështetje të udhëzimit nr. 15, datë 26.11.2018 “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 6, datë 16.01.2018, për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” përcaktohet se:

Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, ofertimi nga Operatorët ekonomik do të bëhet me shumatoren e cmimeve për njësi. Vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së cmimeve për njësi të përlllogaritur për çdo artikull.

- **Operatori ekonomik ”Medial” shpk**

- Operatori ekonomik “Medial” shpk në përgjigje të Dokumentave Standarte të

Adresa: Rruga: “Qamil Guranjaku”, Tirane, Shqipëri, Tel +3554347439, ash@shendetsia.gov.al

Tenderit;

Seksioni 2/1: Kriteret e vecanta të kualifikimit, gërma (d), në të cilën përcaktohet se: Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

“Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”.

si dhe pikës 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” paragrafi i dytë në të cilën kërkohet: *Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave që ka operatori ekonomik që është regjistruar në Shqipëri; Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara me vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimiminë gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik;*

ka paraqitur në SPE:

Vërtetim debie lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nr.1973 prot, datë 20.02.2019 ku citohet: “Bazuar në deklaratimet e deklaruesit (përfaqësuesit ligjor) z. L. Z vërtetojmë se kërkuuesi “Medial” nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit për kontratën/kontratën me kod TR....., TR..... përdorues i të cilave është “MEDIAL” shpk rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën **20.02.2019 duke përfshirë faturën koherente të muajit Janar.**

Vërtetimi lëshohet me kërkesën e “Medial” shpk në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimit publik” dhe jo më vonë se pesë ditë nga data e depozitimit të kësaj kërkesë.

Nga përmbajtja e dokumentit sipërcituar rezulton se Operatori ekonomik “Medial” shpk nuk plotëson kriterin e sipërcituar të vendosur në kërkesat e vecanta për kualifikim në DST përkatësisht kërkesën për **pagesën e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike**, pasi në Vërtetimin e sipërcituar, nuk është përfshirë muaji i fundit i maturuar (muaji Shkurt), referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit datë 08.04.2019.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 5, gërma “c”, përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: “c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më

vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

Në mbështetje të kuadrit ligjor të sipërcituar rezulton se Operatori ekonomik duhej të kishte të përfshirë në Vërtetimin e debisë së dorëzuar në SPE edhe muajin e fundit të faturuar pra muajin Shkurt referuar afatit të fundit të hapjes së ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kite reagent”, 08.04.2019, datëkjo e bërë me dije të gjithë Operatorëve ekonomik përmes Shtojcës së publikuar në SPE në datë 29.03.2019. sipas përcaktimeve të nenit 42, pika 2 dhe 2.1 si dhe nenti 48, pika 2 dhe 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 për “Prokurimin Publik” I ndryshuar.

Thënë sa më sipër, referuar 1. dates se marrjes dijeni për shtyrjen e afatit të fundit për hapjen e ofertave, datë 29.03.2019, referuar 2. datës se përcaktuar si afati I fundit për hapjen e ofertave data 08.04.2019, si dhe parashikimit të bërë në dispozitat e sipërcituara të legjislacionit për Prokurimin Publik për detyrimin që kanë Operatorët ekonomik për të përmbushur kërkesat e Autoritetit Kontraktor, si dhe detyrimit të furnizuesit të energjisë elektrike për të lëshuar vërtetimin e debisë (në rastin konkret të rifreskuar duke përfshirë dhe muajin Shkurt të maturuar) jo më vonë se 5 ditë nga data e depozitimit të kërkesës konkludojmë se Operatori ekonomik “Medial” shpk nuk ka plotësuar kërkesën e Autoritetit Kontraktor të përcaktuar në kriteret e vecanta për kualifikim në Dokumentet Standarte të Tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

Operatori ekonomik ”Krijon” shpk

NIPT: K12023001A

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar: 422.325 (katërqind e njëzetë e dy mijë e treqind e njëzetë e pesë) lekë pa tvsh

Vlera e pritshme e kontrates: 10.098.030 (dhjetë milion e nëntëdhjetë e tetë mijë e tridhjetë) lekë pa tvsh.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Autoritetit Kontraktor: Autoriteti Shëndetësor Rajonal, Tiranë, Adresa: Rruga: “Qamil Guranjaku”, Tiranë, Zyra ligjore, brenda 3 (tre) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 15.04.2019

Ankesa: ka ose jo: Po

Ka marrë përgjigje në datë 24.04.2019